REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
Nr/Br. 163/18
Datë/Datum. 04.05.18
PRISHTINË - PRIŠTINA

Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

AKT PËRCJELLËS

Për:	Menaxherin e prokurimit "Ministria e Zhvillimit Ekonomik OE. "Telekomi i Kosovës"	Kopje:	Paneli Shqyrtues - OSHP
Prej:	Agim Sheqiri – Ekspert Shqyrtues i prokurimit.		
Lënda:	Raporti i Ekspertit Shqyrtues, lidhur me ankesën me Nr. 163/18 të parashtruar nga OE "Telekomi i Kosovës "– Prishtinë.		
Datë	04.05. 2018		

Bazuar në nenin 114 të Ligjit Nr. 04/L-042 i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, ju njoftojmë me raportin, lidhur me ankesën e dt. 20.04. 2018, me nr. 163/18 të parashtruar nga OE "Telekomi I Kosovës"– Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit: "Furnizim me Internet për rrjetin Sizmologjik të Kosovës dhe ledhjet kabllovike për MZHE." me nr prok. 1213-18-1959-121 , iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) Ministria e Zhvillimit Ekonomik (MZHE)

AK, është i thirrur që pas marrjes së raportit të Ekspertit Shqyrtues lidhur më këtë kërkesë, të veprojë sipas kërkesave t

ë nenit 115 të LPP-së.

Të bashkangjitur gjeni raportin e Ekspertit Shqyrtues.

Ti dorëzohet:
OE ankues
Autoritetit Kontraktues – Ministria e Zhvillimit Ekonomik
Panelit Shqyrtues – OSHP

Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

		25.04.2018	03.05.2018
Nënshkrimi i ekspertit		data e autorizimit të ekspertit.	data e dorëzimit të raportit

N. 105, LPP - Baza ligjore e shqyrtimit

Me datën: 20.04.2018 OE. "Telekomi i Kosovës " - Prishtinë, ka parashtruar ankesë në OSHP , kundër njoftimit për kontratë për aktivitetin e prokurimit "Furnizim me Internet për rrjetin Sizmologjik të Kosovës dhe ledhjet kabllovike per MZHE.", me nr me nr prok. 1213-18-1959-121 i iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) Ministria e Zhvillimit Ekonomik (MZHE)

Konform nenit 113, 114 të Ligjit Nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, Eksperti Shqyrtues i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të OE ankues.

Operatori Ekonomik Ankues "Telekomi i Kosovës " – Prishtinë.

Dispozitat e shkelura sipas OE. "Telekomi i Kosovës " "– Prishtinë, janë:

Neni 9.4 — Përcaktimi i nevojave qe duhet te Përmbushen (ligji Nr. 04/L-042 PER PROKURIMIN PUB UK TE REPUBLIKES SE KOSOVES)

Deklarate detale mbi faktet dhe argumentet

Ligji për Prokurim Publik gjegjësisht neni 9 paragrafi 4, kërkon nga Autoritetet Kontraktuese qe *te veprojnë si ne vijim: "autoriteti kontraktues kur është autoritet publik autoriteti i tille publik duhet te marre masa te arsyeshme për t'u siguruar se lëndët qe përmbushin këto nevoja nuk janë ne dispozicion*

nga ndonjë autoritet tjetër publik". Pra neni i larte cituar rregullon rastet kur Autoriteti Kontraktues (Autoriteti Publik) ka nevoje për sigurimin e shërbimeve operator i te cilave po ashtu është një autoritet publik, për me tepër edhe interpretimi i KRPP-se thekson se një autoritet kontraktues publik nuk ka nevoje te procedoj ndonjë procedure te prokurimit përderisa një një shërbim ofrohet nga një autoritet tjetër kontaktues .

Citati:

36. Duke marrë për baze dilemat e shfaqura te Autoriteteve Kontraktuese dhe, kërkesat e shumta te tyre (drejtuar KRPP-es) qe te behet e qarte se si duhet të veprohet ne rastet kur një Autoritet Kontraktues (Autoritet Publik) ka nevojë për sigurim të shërbimeve të cilat i posedon një Autoritet tjetër po ashtu publik?

Konform nenit 87, paragrafit 2, nen paragrafit 2.8 te Ligjit Nr. 05/L-068 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik, KRPP ofron interpretim ligjor a i përket çështjes se parashtruar me larte, Ligji për Prokurim Publik gjegjësisht neni 9 paragrafi 4, kërkon nga Autoritetet Kontraktuese që te veprojnë si ne vijim:

"Nëse autoriteti kontraktues është autoritet publik, autoriteti i tillë publik duhet te marre masa te arsyeshme për t'u siguruar se lendet qe i përmbushin këto nevoja nuk jane ne dispozicion nga ndonjë autoritet tjetër publik
Pra neni i larte cituar rregullon rastet kur Autoriteti Kontraktues (Autoriteti Publik) ka nevojë për sigurimin e shërbimeve operator i te cilave po ashtu është një autoritet publik.

LPP, nuk e sqaron me tej se si autoritet publike do te rregullojnë plotësimin e nevojave te tyre (ne mes vete) me që kjo është çështje e autoriteteve publike dhe/ose rregullave tjera.

Mirëpo është mese e qarte se këto raste kane te beje me përjashtimet nga zbatimi i legjislacionit qe rregullon prokurimin publik kur një forme e partneritetit publiko privat realizohet (një AK mund te kërkoje ofrimin e një shërbimi ne shërbimet e te ose shërbimeve te një autoriteti tjetër kontraktues pa iniciuar ndonjë procedure tenderimi, te ashtuquajtura përjashtim në shtëpi).

Si përfundim pas analizimit te cekur me larte (neni 9.4 te LPP-se) dhe te kërkesave tuaja, me qe nuk ka asnjë dispozite tjetër te LPP-së e cila i obligon Autoritetet Publike qe te marrin masa për te mos lejuar "shtrembërimin e konkurrencës" (sikur ato nga direktiva e BE-es, neni 12.1) KRPP nuk ka se site mos e trajtoje ketë çështje ashtu sikur është vendosur ne nenin 9.4 te LPP-se.

KRPP, nuk do te publikoj asnjë lloj Njoftimi (Njoftimi për kontratë Njoftimin për dhënie apo për nënshkrimin e kontratës) dhe do te deklaroj aktivitetet, vendimet dhe/ose kontratat jo ligjore ne rast se nuk janë respektuar dispozitat e cekura me larte apo cila do dispozite tjetër e legjislacionit

për prokurim publik

LINKU: https://lappxlcs-gov.net/Default. aspx?PID=NewsPub&LID= 1 &PCID=- 1 &CtlID=H'TMLStatic&CID=PPRCNews&ID=3 13

Propozim i Telekomit të Kosovës –Te anulohet Njoftimi për kontrate nga MINISTRIA E ZHVILLIMIT EKONOMIK dhe te fillohet një procedure e re ne përputhje me interpretimin e KRPP_se dhe ne kërkesat e nenit 9.4 te LPP-se. Dmth MINISTRIA E ZHVILLIMIT EKONOMIK nuk ka nevoje te përdor procedure te prokurimit, pasi qe shërbimet ofrohen nga një institucion publik qe përdor fonde publike.

Mënyra proceduese e anulimit është: MINISTRIA E ZHVILLIMIT EKONOMIK duhet te kërkoj nga KRPP ose autorizim që te beje anulimin e Njoftimit për Kontratë

Demet Materiale

Demet materiale qe mund te shkaktohen nga mos përdorimi i PP-se nga ana e MINISTRIA E ZHVILLIMIT EKONOMIK janë shume te mëdha dhe ne vlere monetare ato mund te shkojnë me mijëra euro, përafërsisht 15.000,00 euro për 36 muaj.

Këto deme ne mënyrë te drejtpërdrejtë dëmtojnë BUXHETIN e KOSOVES pasi qe TELEKOMI I KOSOVES është ndërmarrje publike dhe siç e ka përcaktuar KRPP konsiderohet blerje ne SHTEPI.

Procesi i prokurimit:

Data e njoftimit për kontratë: .....12..04.2018

Lloji i procedurës së aplikuar:.....Procedurë e hapur

Lloji dhe vlera e kontratës së publikuar:..... Kontratë për shërbime me vlere te mesme

Vlera e parashikuar e kontratës:..... 15,000.00 €

Kriteri për dhënie të kontratës(N.52)..... tenderi i përgjegjshëm me çmim më të ulët.

Afati i fundit për dorëzimin e ofertave. 19.04.2018

Data e hapjes së ofertave 19.04.2018

Data e përfundimit të vlerësimit të ofertave ..... nuk është bërë vlerësimi i ofertave sepse është pezulluar aktiviteti i prokurimit

Data e njoftimit për dhënie t ë kontratës ..... Aktiviteti i prokurimit nuk ka përfunduar

Data e kërkesës për rishqyrtim..... 18.04.2018

Data e vendimit të AK-së lidhur me kërkesën për rishqyrtim 23.03.2018

Kriteret për kualifikim:

II.2.1) Kërkesat e përshtatshmërisë:
1.Deklarata nën betim se operatori përmbush kërkesën mbi përshtatshmërinë të ligjit të prokurimit , Ligji Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092. (Obligative për të gjithë OE
1.Deklarata nën betim se operatori përmbush kërkesën mbi përshtatshmërinë të ligjit të prokurimit , Ligji Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092. (Obligative për të gjithë OE
3.Vërtetim nga Gjykata Ekonomike- që nuk është në procedurë gjygjësore ose i dënuar më parë për vepër penale,vertetimi jo më i vjetër se tre muaj përpara dorëzimit të tenderit.Vetëm për tenderuesin e propozuar për dhënje të kontratës
3.Çertifikatën e TVSH-së
Dëshmia e kërkuar dokumentare:
1.Deklarata e nënshkruar dhe e vulosur duke përdorur formën standarde në dosjen e tenderit (origjinal
2.Vërtetim nga ATK-ja se nuk ka borxhe ndaj shtetit të Kosovës ose marrëveshjen me ATK, jo me i vjetër se 3 muaj nga data e shpalljes së tenderit.
3.Vërtetimin nga Gjykata Ekonomike-
3.Çertifikatën e TVSH-së(kopje)

II.2.2) Përshtatshmëria profesionale:
1.Regjistrimin si operator ekonomik në regjistrin profesional, komercial dhe/ose të korporatës në shtetin e themelimit të operatorit ekonomik-ÇertifikataRegjistrimit të Biznesit
2.Çertifikata e Numër Fiskal

Dëshmia e kërkuar dokumentare:
1.Çertifikatën e regjistrimit të biznesit me llojet e veprimtarive të regjistruara- (kopje).
1.Çertifikatën me numër fiskal (kopje)
III.2.3) Kapaciteti ekonomik dhe financiar:
1.Kërkesa1.Operatori ekonomik duhet të ofrojë dëshmi të kënaqshme se qarkullimi vjetor i OE, ose grupit të OE-ve gjatë 3viteve të fundit(2015,2016,2017) ka qenë në vlerë, së bashku në të tri vitet, prej jo më pak se 20,000.00€.

Dëshmia e kërkuar dokumentare:
1.Pasqyrat Financiare të audituara nga ndonjë firmë e njohur e licencuar për auditim ose auditor pavarur i licencuar për tri vitet e fundit (2015,2016,2017) (të bashkangjitet kopja e noterizuar e certifikatës së auditorit).
III.2.4) Kapaciteti teknik dhe profesional:
Kërkesa 1. OE- duhet të ofroj dëshmi të mjaftueshme se ka realizuar punë të ngjashme në tri vitet e fundit (2015, 2016, 2017), në vlerë minimale 20.000,00 €.
v Dëshmia e kërkuar dokumentare:
Për kërkesën 1. Lista e kontratave të realizuara në tre vitet e fundit (2015, 2016, 2017) për punë - (të ngjashme) të dëshmohet me referencë pozitive, apo raporte te pranimit teknik.

Regjistri i ofertuesve sipas procesverbalit të hapjes publike:

Nr	Operatorët Ekonomik	Vendi	Çmimi €
1	"IPKO-Telecommunications "	Prishtinë	4,947.84

Komisioni vlerësues pranë AK:

Autoriteti Kontraktues me vendim nr. protokolli 768 me datë 20.04.2018 për vlerësimin të ofertave ka caktuar komisionin në përbërje, si në vijim:

1. Ismet Shala – Kryetar i komisionit
2. Drilon Mulliqi– Anëtar e komisionit
3. Fahrije Qorraj Kaloshi – Anëtare e komisionit

Raporti i komisionit vlerësues:

AK nuk ka filluar me vlerësim të ofertave për ketë aktivitet të prokurimit pasi që ankesa në OSHP është parashtruar një ditë pas hapjes publike të ofertave

Përgjigje në pretendimet ankimore të OE ankues "Telekomi Kosvës" -Prishtinë.

Sqarim Hyrës:

Pas publikimit të njoftimit kontratëOE ankues me datë 13..04.2016 parashtron kërkesë për rishqyrtim në AK, por kërkesa e tillëi refuzohet si e pa bazuar me arsyetimin se për këto shërbime janë më tepër se 76 operator ekonomit të licencuar dhe është e nevojshme të zhvillohet konkurrencë pasi QELLIMI I NENIT 1 të LPP-së është ruajtja buxhetit në të kundërtën konsiderohet si keq menaxhim.

Përgjigjeje në pretendimet ankimore:

Duke iu referuar pretendimeve ankimore Eksperti Shqyrtues sqaron se me nenin 9.4 të Ligjit për Prokurim Publik KRPP ka lëshuar në interpretim ligjor sipas së cilit AK nuk kanë nevojë të prokurojnë shërbimet e tilla.

Duke iu referuar këtij interpretimi Eksperti Shqyrtues mendon se kërkesa paraprakisht për rastin konkret duhet drejtuar KRPP-së pasi qe përmes KRPP publikohen njoftimet për kontratë për aktivitet e prokurimit që duhet ndjekur njërën nga procedurat e parapara me LPP-në.

Sipas interpretimit të KRPP-së shërbimet e tilla nuk kanë nevojë të prokurohen, dhe nëse nuk ka nevoje te prokurohen atëherë publikimet e tilla nuk kanë nevojë të bëhen përmes Web faqes se KRPP-sepse në rastet e tilla nuk kemi të bëjmë me modulin e blerjes por me modulin e aprovimit për shpenzimin e parasë publike, dhe kjo nënkupton se AK-të nuk kanë nevojë të publikojnë njoftimet e tilla për kontratë pasi q ë në kuptim te nenit 9.4 të LPP-së Telekomi i Kosovës ka parashtruar një numër të madh të ankesave .

Te gjitha shpenzimet që nuk i nënshtrohen modulit të blerjes atëherë nënkupton qe ankesat e tilla nuk trajtohen nga OSHP me përjashtim me prokurimit e mbyllura në kuptim të nenit 132 të LPP-së

Shkeljet e konstatuara të LPP-s

Duke iu referuar interpretimit te KRPP-së nr. 36 dhe vendimeve paraprake te OSHP-së lidhur me ankesat që ka parashtruar Telekomi i Kosovës për shërbime të ngjashme Eksperti Shqyrtues konsideron se AK nuk ka respektuar nenin 9.4 të LPP-së.

Sipas atij interpretimi Autoritetet Kontraktuese për shërbime te tilla nuk kanë nevojë të ndjekin procedurat e prokurimit që parashihen me LPP pasi qe Telekomi i Kosovës është gjithashtu Autoritet Publik dhe kjo nënkupton se për këto shërbime Autoritetet Kontraktues nuk kanë nevojë ti nënshtrohen konkurrencës, por shërbimet e tilla ti realizojnë përmes modulit të aprovimit.

Mendimi i ekspertit shqyrtues

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, Eksperti Shqyrtues i propozon Panelit Shqyrtues që ankesa e OE ankues Telekomi i Kosovës të pranohet si e bazuar dhe kërkon që njoftimi për kontratë i Autoritetit Kontraktues të anulohet .